REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 22 nëntor 2012, nenit 4, 5 të Rregullores Qrk Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31. 01.2018, pas shqyrtimit te propozim vendimit te Kryetarit miratoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmëritë-lokalet afariste në pronësi të komunës, të cilat gjenden në kuadër të ndërtesës së ndërtuar me koncesion "Besa Comerc" e koncentruar në parcelat kadastrale P-71409044-01187-1, P-71409044-01923-0 dhe P-71409044-01930-1, rruga "Lidhja e Prizrenit" zona kadastrale në Lipjan, si në vijim:

1.1. Lokali afarist në përdhesë me sipërfaqe prej 159m^2

1.2. Lokali afarist në katin e parë me sipërfaqe prej 140m^2

1.3. Bodrumi me sipërfaqe prej 239.70m^2

1.4. Lokali afarist me sipërfaqe prej 120m^2 parcela kadastrale P-71409044-01773-1 i cili gjendet në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat-lokalet afariste ipen në shfrytëzim afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores Qrk Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Dhënia e lokaleve në shfrytëzim sipas këtij vendimi bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale.

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në bazë të Rregullores Qrk Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pjesërisht paragrafi 1.3 përkatësisht vetëm lokali me sipërfaqe prej 159 m^2 dhe paragrafi 1.5 i pikës 1 të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014.

15Nr. 463 – 6525
Lipjan, më 01. 02. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT I LIPJAN OPŠTINA LIPJAN REPUBLIKA KOSOVO

KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi